



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Drenasit  
Kuvendi i Komunës



02Nr. 060103-3595 dt. 22/01/ 2024

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Milaim Hajdari, më datë: **29.01.2024** (E Hënë) duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET  
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal i dt. 27.12.2023
2. Raporti Financiar Janar-Dhjetor 2023.
3. Propozim Vendim për ndarjen dhe bashkimin e parcelave kadastrale.
4. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për realizimin e Projektit për ndertimin e objekteve të qerdheve në Tërstenik dhe Nekoc.
5. Propozim Vendim për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik/juridik (për 99 vite).
6. Raporti i punës së Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale për vitin 2023.
7. Raporti i punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm të Komunës së Drenasit për vitin 2023 dhe plani i implementimit të rekomandimeve .
8. Raporti i performancës komunale për vitin 2022.
9. Raporti i komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës të dhëna në shfrytëzim gjatë vitit 2020.
10. Plani i Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
11. Të ndryshme.

Drenas, 22.01.2024



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari



Republika e Kosovës  
Komuna e Drenasit  
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 334/05-3968 dt. 22/10/2024

**PROCESVERBALI**

Të mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: **27.12.2023**  
e cila filloi në orën 10:00.

**Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari**

**Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 30 anëtarë:** Labinot Halilaj (PDK), Bekim Lestrani (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Blerina Gashi (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Qendrim Mulaj (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Blerina Gashi (PDK), Albulena Saliuku (PDK), Valentina Leku (PDK), Manushaqe Mulaku (PDK), Mirlinda Dvorani (PDK) Sali Dvorani (DD), Mergim Pirraku (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Florentina Elezi-Veliu (VV), Filloreta Bujupi (VV), Drin Halilaj (VV), Egzona Terrdevci (VV), Muhamet Kurtaj (VV), Arbër Halilaj (GREEN), Beqir Kiqina (AAK), Egzon Qorri (LDK). Sali Dvorani (DD). **Mungoi Muhamet Kurtaj.**

Të pranishëm ishin edhe **Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, Nënkyetari Arben Shala, Drejtor të Drejtorive komunale, përfaqësues të KFOR-it zyra e informimit, qytetar dhe Xheneta Murtezaj për Raportim të ekipit të Auditimit Social në Drenas**

Mbledhja filloi punimet me këtë rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Komunal i datës 22.11.2023.
2. Propozim vendim për shpalljen e z. Hashim Thaqi "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit.
3. Propozim vendim për shpalljen e z. Kadri Veseli "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit.
4. Propozim vendim për shpalljen e z. Jakup Krasniqi "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit.
5. Propozim vendim për shpalljen e z. Rexhep Selimi "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit.
6. Plani i Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2024.
7. Plani vjetor i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024.
8. Lista e Rreziqeve Komunale për vitin 2024.
9. Propozim vendim për financim të projektit në projektin e Jehona Hoxha.
10. Propozim për ndryshimin/korrigjimin të vendimit për financimin e projektit Drilona Krasniqi.
11. Propozim për ndryshimin/korrigjimin të vendimit për financimin e projektit Sabahate Gashi.

12. Propozim për ndryshimin/korrigjimin të vendimit për financimin e projektit Doruntina Shehu.
13. Lista me anëtarët për Komitetin Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport i propozuar nga paneli përzgjedhës nga Kuvendi Komunal Drenas.
14. Lista me anëtarët për Komitetin Konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale nga paneli përzgjedhës nga Kuvendi Komunal Drenas.
15. Lista me anëtarët për Komitetin Konsultativ për Komiteti për Personat me Aftësi të Kufizuar i propozuar nga paneli përzgjedhës nga Kuvendi Komunal Drenas.
16. Propozim për ndryshim-plotësimin e rregullores për taksa tarifa, ngarkesa dhe gjoha Nr. 02-400/01-57198 të datës 22.11.2023.
17. Raporti i ekipit të Auditimit Social në Drenas.
18. Raporti i vitit 2023 për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
19. Raporti vjetor i punës për vitin 2023 i Komitetit për Komunitete dhe Kthim.
20. Raporti vjetor i punës për vitin 2023 për Komitetin Konsultativ për Barazi Gjinore.
21. Të ndryshme.

Mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Drenasit u mbajt me dt. 27.12.2023, ku për diskutim ishin 21 pika për rend dite. Mbledhja është kryesuar nga kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari. Kryesuesi hapi punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal ku njoftoi me rendin e ditës e lartcekur.

Meqë nuk pati diskutime apo vërejtje tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, “Për” votuan 29 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua rendi i ditës me pikat e lartcekura.

**Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

**1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 22.11.2023.**

Meqë nuk pati diskutime apo vërejtje tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, “Për” votuan 28 anëtar, kundër nuk pati, 1 abstenim, u miratua procesverbali i mbledhjes së rregullt të KK i mbajtur më dt. 22.11.2023

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Propozim vendim për shpalljen e z. Hashim Thaqi “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.**

**Egzona Tërdevci:** Para votimit të këtyre pikave janë disa çështje që dua t'i diskutoj.

Edhe unë, si shumë fëmijë të tjerë të Kosovës, kam pas fatin e keq të lind në një vend të pushtuar e të rritem në kohë lufte.

Gjenerata ime dhe shumë gjenerata tjera më pas, janë rritë me dashuri e admirim për Ushtrinë tonë Çlirimtare o heronjtë o vendit tonë.

Është e trishtueshme që në kohën kur ne po diskutojmë për ta pikërisht ata që luftuan për lirinë tonë, të mos kenë mundësinë ta shijojnë atë, por të akuzohem se mbrojtëm vendin e tyre me dinjitet, duke mos dashur të bëj asnjë deklaram që do të mund t'i dëmtonte ndonjërin prej tyre, e ndjej për obligim t'i ngris disa dilema rreth këtyre propozimeve.

Zotëri Lladrovci, po të kërkoj emrin tuaj dhe emrin e personave që sot shpallen qytetarë

nderi, ndër lajmet e para janë akuzat që ju keni bërë ndaj tyre pikërisht për çështje të luftës. Është hipokrizi që sot për poena politike ta sillni një propozim të tillë, kur në kohë jo shumë të largët ata kanë marrë akuzat nga vetë ju, më e pakta që mund të bëni para këtyre votimeve është të kërkonit falje nga ta dhe nga të gjithë të tjerët që janë ndikuar nga akuzat e juaja drejt tyre.

Është paradoksale që njerëzit që vetë i keni akuzuar t'i propozoni t'i shpallni qytetarë nderi sot, të paktën jo pa pranuar gabimet tuaja të se kaluarës në raport me ata dhe pa kërkuar falje. Është edhe një çështje tjetër të këto propozime nëse duam të shpallim të vlerësojmë mirënjohje e të shpallim një vlerësim për personat që po e ndajnë këtë titull, do të duhej që neni dy, pra arsyeja pse e ndajnë këtë titull të ishte i njëjtë për të gjithë, e në veçanti shqetësues është propozimi tek pika katër për z.Krasniqi.

Më lejoni ta citoj këtë nen nga propozimi që na e keni sjellë.

Titulli qytetar nderi për z. Jakup Krasniqi i jepet për kontributin e tij në shtet formim dhe shtet ndërtim dhe proceset historike që ka kaluar Kosova, Tek propozimi për shpalljen e tij qytetar nderi nuk përmendet fare pjesa për kontributin e tij në luftën çlirimtare.

Uroj që ky gabim të jetë veç pasojë e neglizhencës, sepse me gjithë mllëfin që keni shfaqur për të në periudha të ndryshme nuk dua të besoj që keni aq dashakeqësi sa ta mohoni kontributin e luftë.

Me gjithë këto vërejtje, në emër të Grupit të Lëvizjes Vetëvendosje, potencoj edhe një herë se nuk jemi, e as nuk kemi qenë asnjëherë kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e as kundër historisë tonë të lavdishme për çlirim e pavarësi.

Si grup i asamblistëve të Lëvizjes Vetëvendosje, ne do të votojmë pro këtyre propozimeve, duke shprehur mirënjohjen për kontributin e secilit nga bashkatdhetarët tanë që gjendet në Hagë. Gjithësi konsiderojmë që në një situatë të tillë ju do të përmirësoni gabimet karshi tyre duke kërkuar falje publikisht për akuzat tuaja por dhe do ta përmirësoni gabimin tek pika katërt.

**Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci:** Për asnjë gjë në botë unë deri sot që e kam bërë nuk kam nevojë me kërku falje dhe nuk kërkoj falje.

Nuk du me prish këtë solemnitët, sepse ata janë katër djem drenicak, të cilët na kanë bërë krenarë, në shumë situata, si në themelimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si në themelimin e shtetit të Kosovës, më vjen keq që disa provojnë këtë solemnitët me e prishë.

Nuk muni me e prishë, as s'keni mujt kurrë me e prishë.

Unë jam kanë edhe në vizitë tek ata, më keni shpallë edhe dëshmitarë të Hagës, po as njana as tjetra nuk ka ekzistë dhe nuk ka me ekzistë kurrë.

Vullneti i qytetarëve të Drenasit është që heronjtë e tyre të luftës e të paqes t'i kanë qytetarë nderi të komunës së vet, pra të komunës së Drenasit.

Na si regjion jemi-Drenicë, edhe drenicakët e vet do me i pasa qytetarë nderi.

Unë e kam bo veç një propozim të vullnetit të shumicës të qytetarëve nderit.

Ne e dallojmë kundërshtitë politike me çështjet që kanë të bëjnë që janë fundamentale.

As unë pa dashtë me ndërhyrë në çështje të cilat unë nuk jam i thirrur me i dëmtu, po jam i thirrur me ndihmu si proces, sepse procesi nuk bëhet përkatë djemtë Drenicës, po bëhet për Kosovën edhe unë jam shumë i bindur që ata do të kthehen fitimtarë.

**Egzona Tërdevci:** veç në diçka pajtohna me juve dhe unë du me i pa ata katër njerëz të kthy fitimtarë, sepse fitore e tyre është fitore e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, rrjedhimisht është edhe e shtetit tonë.

Për të mos me dash me prishë këtë seancë solemne, insistoq që veç te pika e katërt me u ba përmirësimi edhe të katërtit të nderohen për kontributin në luftë, ndoshta është gabim teknik por kërkoj ta përmirësoni.

Meqë nuk pati diskutime apo vërejtje tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, “Për” votuan 29 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim vendim për shpalljen e z. Kadri Veseli “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.**

Meqë nuk pati diskutime apo vërejtje tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, “Për” votuan 29 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati u miratua kjo pikë e rendit të ditës

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: **4. Propozim vendim për shpalljen e z. Jakup Krasniqi “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.**

**Egzona Tërdevci:** propozoj që të ndryshohet neni dy, pra pika ku njihet kontributi i tij, të përmendet edhe kontributi i tij në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

**Ramiz Lladovci Kryetar i Komunës:** Nuk i mohohet askujt kontributi për asnjë gjë dhe nuk ju ka mohua as aty, as pikën dy, as pikën tre, ata shpallën heronjtë qytetarë nderi të komunës qytetarë të njëjtë, të barabartë.

Meqë nuk pati diskutime apo vërejtje tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, “Për” votuan 29 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Propozim vendim për shpalljen e z. Rexhep Selimi “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.**

Meqë nuk pati diskutime apo vërejtje tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, “Për” votuan 29 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Plani i Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2024.**

**Egzona Tërdevci:** janë disa propozime që ne i kemi lidhur me planin e punës.

Nëse e ngritni si dilemë se nuk i kemi dërgu me shkrim, nuk i kemi dërgu se edhe kur po i dërgojmë, më herët nuk është që po merrem parasysh, po po dojmë me shtrë këtu për diskutim para të gjithë juve.

Në janar të shtohet edhe prezantimi para asamblesëve në detaje për planin e prokurimit për vitin 2024.

E dimë që një dokument i tillë është publik në faqe të komunës, por kur po diskutojmë për buxhetin, sepse nuk po bahet një ndarje më e qartë e projekteve, gjithmonë po na thuhet që është një plan i brendshëm, le të vjen ai plan i brendshëm dhe le të prezantohet para

asamblesë.

Në janar po ashtu të shtohet raportimi lidhur me dhënien e pronave në shfrytëzim për të gjitha pronat që janë në shfrytëzim afatgjatë, që janë dhënë përgjatë këtij mandati, këtë pikë e kemi kërku edhe në seancat tjera, po na shton që nuk keni mundësi për shkak se e kemi zyrtarin në pushim me u përgatitë, konsideroj që në janar është koha e mjaftueshme për me u përgatitë. Në shkurt dhe në mars është paraparë të trajtohet plani i transparencës, konsiderojmë që një plan i tillë mjafton të trajtohet në një seancë të vetme, pra vlerëson jo nëse është më e drejtë të trajtohet në shkurt apo në mars.

Në maj ose varësisht nga fakti se si mund të organizohen drejtoritë, të sillet raport në Kuvend Komunal për të gjitha subvencionet që janë ndarë nga Kuvendi për vitin paraparak.

Në korrik, kur diskutohet raporti nga Zyra Kombëtare e Auditimit në korrik të raportojnë të gjitha drejtoritë që kanë buxhet për investime kapitale lidhur me realizimin e investimeve kapitale.

Në korrik të bëhet një rishikim i planit të punës për kuvendin e komunës dhe varësisht nga plani të ri-planifikohet pjesa tjetër e vitit.

Në korrik po ashtu të prezantohet edhe raporti financiar gjashtëmuor, i cili në planin aktual është i planifikuar të prezantohet në shtator dhe konsiderojmë që në korrik është mjaftueshëm kohë e përshtatshme për t'u përgaditur. Në nëntor, kur është paraparë, të raportojnë disa drejtori lidhur me investimet kapitale, të raportojnë të gjitha ato që kanë buxhet të destinuar për investime kapitale, e jo vetëm ato që janë cekur në plan.

Nga viti 2021, kur ne si legjislaturë e kemi bërë betimin si asamblesë, ne çdo herë kemi pasur në plan pune njëmbëdhjetë seanca, por i kemi mbajtur nga dymbëdhjetë.

Pra, prej vitit 2022-2023, ne kemi mbajtur seanca edhe në gusht të definohet kjo pjese nese planifikoni ti keni 12 atehere t'i kemi edhe në plan të punës ashtu. Në qershor shtator, varësisht nga koha se si mund të përgatitet ekzekutivi, të ketë një raportim për gjashtëmuorin e funksionimit të ndërmarrjes lokale Stacioni i autobusëve Sha-Drenas, pasi e kemi nda kapitalin edhe kam pa që shpall edhe konkursi, po besoj që kompania shpejtë fillon punën.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci:** raportet që i kanë parapame me ligj, as unë i shton ti, as nuk mund t'i heq ti.

Nëse raportin financiar për gjashtë muor e ke na në muajin e shtatë, e bëjmë muajin e shtatë, se s'mujna pa i marrë raportet e fribalancit, na nuk mujna me raportu.

**Kryesuesi i Kuvendit Milaim Hajdari:** Unë konsideroj që pjesa dërmuese e çështjeve që ngriti Egzona janë në planin e punës, ose janë forma të ndryshme të shkruara ndryshme, po pjesa dërmuese është përfshirë.

Megjithatë, ajo çka është e mundshme do të thotë me inkorporu në plan të punës, na e inkorporojmë, besoj se Sekretaria i ka marrë këto kështu që nuk kemi ndonjë telashe lidhje me këto, për çështje që mendojmë që janë të drejta për t'u diskutu ose për t'u plotësu, megjithatë ne jemi Kuvendi këtu çdo muaj dhe për secilën çështje kemi të drejtë me ngritë, mundemi ta ngitum në mbledhjen e radhës.

**Egzona Tërdevci:** Nëse në prill është e mundur të prezantohet raporti financiar, po po mujka me u bë mbyllja brenda një muaji, pse nuk mund edhe në korrik me u ba raporti por deri në qershor.

S'ka logjikë me thanë që s'mundet me u përgatitë, se mundet, po nëse ju e vlerësoni që duhet me kanë shtatori, e rëndësishme me ardhë raporti, unë si Asambleistë e kërkoj që të hidhen

propozimet tona në votim nëse i marrim votat, pra se inkorporohen në plan, nëse nuk i marrim votat megjithatë e vlerësoni ju.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci:** Pra, afatet ligjore as m'i ndrron ti, as Kuvendi e as askush, sepse janë afate ligjore që i ka parapare niveli qendror, për raportim financiar. Për raportim për dhënien e pronave është gati raporti. Mund edhe sot të ndryshme me raportu, nuk kemi asnjë lloj problemi.

**Labinot Halilaj:** Ky është propozim, plani i punës. Zakonisht kur të bohet plani i punës, ajo sigurisht që nuk bëhet edhe me deri detajet e fundit, po është ajo plani i punës, vija e trasha, është plani i punës edhe kur të bëhet plani i punës nuk është që plani i punës të bëhet edhe deri në detaje. Ka mundësi që domethënë shumë herë edhe plani i punës me i ikë tema që njëfarë mënyre që janë në interes edhe të Kuvendit po edhe të ekzekutivit për mu diskutu. Po ato mujn me u inkorporu edhe gjatë periudhës kur kena seancë nuk është që eventualisht domethënëpse s'mundet asni plan i Kuvendit, edhe na me ka pjesë e hartimit të tina që me i përfshijë të gjitha temat që kam për diskutim. Nëse eventualisht, domethënë ne nuk jemi të inkorporum në këtë plan, bëjmë seanca të tjera, mundet me e inkorporu ne vetë, mundet me ndryshu planin. Në janar në seancë, në janar mundet me diskutu edhe një plan që me i shtu edhe këtu, me i shtu edhe këtu. Vija e trasha votohet ky plan edhe mandej s'është telashe. Ne s'mundemi me bo raportim sipas dëshirës, janë afatet ligjore, na s'munda me votu në diçka që është kundërshtim me ligjin.

**Beqir Kiqina:** Kisha propozu kryesuesit që në këtë rast mu merr me planin e punës edhe herave të tjera me thirr do të thotë shefat e grupeve kuvendare ose përfaqësuesit domethënë të subjekteve politike shefat e grupit, në mënyrë që mu konsultu për planin e punës, e pse jo mujna me bo edhe një plotësim-ndryshim ndoshta edhe në fillim të vitit të ardhshëm edhe mu konsultu për planin e punës, sepse plotësi-ndryshimet lejohen me Rregulloren e Kuvendit.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci:** sot duhet ta votojmë, sepse është thirrje e sqaroi Labinoti fort mirë prapë po themmua nuk u takon me u përzi në planin e juaj, por edhe një herë po jua kujtoj, propozimi i parë qitet, propozimi i juaj, pastaj i dyti.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari,** çdo seancë, anëtarët e Kuvendit kanë të drejtë me ba propozime për çështje të caktura që ju interesojnë. Dhe nuk e di cili është nuk e di cili është nuk e di cili është halli do të thotë që me bo kaq të madhe këtë punë. Unë e thashë Fillimisht, e thashë me modestinë ma të madhe, ne e kemi bërë një thirrje për punëtori, pikërisht për të diskutu, për të mbyllë debatin kur të vijmë ne këtu me ardhë e qartë në lidhje me planin e punës. Edhe në janar domethënë ulemi grupet parlamentare e diskutojmë, merreni vesh çka ka mundësi me inkorporu në plan punës grupet parlamentare do të thotë i bëjna pjesë e planit të punës.

**Egzona Tërdevci:** është e padrejtë me thanë që s'po pajtohem, po diskutojmë kot, se nuk është diskutim kot diskutimi për planin e punës. Në rregull, nëse është me të vërtetë përcaktim ligjor, po po pajtohem që pjesën pikën për

raportin financiar unë po e tërheq në emër të Asambleve Vetëlvizjes Vetëvendosje, silleni sipas planit të punës.

Po nuk mundesh me thanë që qitet në fillim propozimi juaj në votim, pastaj joni, se na Ne jemi tu bo amendament në planin e punës që e kemi marrë.

Nuk e kuptoj çfarë shton kjo frikë, çfarë shton ky hezitim me i qitë propozimet tona në votim. Asnjë propozim i joni si asamblesë nuk është tu u qitë në votim.

Ju lutna, respektoni Rregulloren, respektoni ligjin, jepna të drejtën si asamblesë t'i hedhni në votim propozimet tona, nëse nuk kalojnë na nuk mundemi me i marrë votat me zor.

Thjesht, hidhnim votim propozim-ndryshimin.

Para se të hidhet komplet plani i punës, i merr votat propozim-ndryshime që i kemi ba, e votojmë planin të tillë me propozimet tona.

Nuk i merr votat, hidhe në votim propozimin tjetër, po nuk mundesh me krahasu se na nuk kemi dërgu komplet plan të punës.

Na jemi tu propozu veç ndryshime shitesë, pa pjesën për raportim financiar të gjashtë mujor, të cilin po e tërheki duke i respektuar afatet ligjore, edhe pse jam shumë e bindur që mundet me u bë në korrik, po nuk po du me e zgjat më shumë këtë temë.

Atë pikë e tërhekun pikat tjera, ju lus që t'i hedhim votim, sepse është e drejtë e jona si asamblistë që japim propozime dhe të njëjtat të hidhen votim.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari:** unë e kisha propozu që në janar do të bëhen përfaqësues të grupeve parlamentare të diskutojnë edhe do të me gjete ata të gjuhë të mirëkuptimit, mirëpo pjesë me inkorporu.

Meqë nuk pati diskutime apo vërejtje tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, “Për” votuan 29 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: **7. Plani vjetor i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024.**

Meqë nuk pati diskutime kaloj tek pika tjetër.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: **8. Lista e Rreziqeve Komunale për vitin 2024.**

Meqë nuk pati diskutime kaloj tek pika tjetër

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës: **9. Propozim vendim për financim të projektit në projektin e Jehona Hoxha**

Meqë nuk pati diskutime apo vërejtje tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar, “Për” votuan 27 anëtar, kundër nuk pati, 1 abstenim u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dhjetë të rendit të ditës: **10. Propozim për ndryshimin/korrigjimin të vendimit për financimin e projektit Drilona Krasniqi.**

**Egzona Tërdevci:**Nëse na kishin ardh materialet kur na i kemi kërku si asamblesë për këto subvencione, ndoshta ishin evitu me kohë ky gabim, po keni zgjedhë me mbajë qeverisjen të mbyllne dhe me i bo sendet ad hok e në mënyrën më të keqe qysh jeni mësu, na nuk i mbështetim këto propozime, sepse nëse kishin ardhë me kohë materialet kishim mujt me evitua këto gabime.

Meqë nuk pati diskutime apo vërejtje tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar, “Për” votuan 26 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës: **11. Propozim për ndryshimin/korrigjimin të vendimit për financimin e projektit Sabahate Gashi.**

Meqë nuk pati diskutime apo vërejtje tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 22 anëtar, “Për” votuan 22 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës: **12. Propozim për ndryshimin/korrigjimin të vendimit për financimin e projektit Doruntina Shehu.**

Meqë nuk pati diskutime apo vërejtje tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 22 anëtar, “Për” votuan 22 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës: **13. Lista me anëtarët për Komitetin Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport i propozuar nga paneli përzgjedhës nga Kuvendi Komunal Drenas.**

Miratohet lista e anëtareve të Komitetit të Konsultativ Komunal për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, në përbërje prej pesë (5) anëtarëve si vijon:

1. Leordita Shabani
2. Avni Mehani
3. Teuta Gashi
4. Lulzim Ademi
5. Xhensika Gashi

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e katërbëdhjetë të rendit të ditës: **14. Lista me anëtarët për Komitetin Konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale nga paneli përzgjedhës nga Kuvendi Komunal Drenas.**

Miratohet lista e anëtarëve të Komitetit të Konsultativ Komunal për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në përbërje prej pesë (5) anëtarëve si vijon:

1. Betim Morina
2. Lirie Bardhi
3. Arbenitë Rama
4. Qëndresë Bardhi
5. Xheneta Hoxha

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pesëmbëdhjetë të rendit të ditës: **15. Lista me anëtarët për Komitetin Konsultativ për Komiteti për Personat me Aftësi të Kufizuar i propozuar nga paneli përzgjedhës nga Kuvendi Komunal Drenas.**

**Beqir Kiqina:** Sa i përket pikës së pesëmbëdhjetë për kandidatat për Komitetin Konsultativ për Aftësuar për persona me aftësi të kufizuar, Unë konkretisht kisha dashtë me falënderu Komisionin, i cili e paska ba një vlerësim të mirë, për arsye se rrallëherë në këto pika përmendet Komisioni dhe duhet të përmendet, për arsye se këtu është inkorporu edhe një përfaqësues i organizatës humanitare e quajtur Hendikës që më herët ka mungu dhe po mendoj që është një ndër institucionet më kompetente dhe relevante në Komunën e Drenasit që mundet me dhanë kontributin e vet, do të thotë në këtë komision dhe i përgëzoj edhe komisionin për një përzgjedhje të tillë dhe shpresoj sepse është një komitet një komitet i cili e ka një vendësi dhe është shumë specifik dhe shpresojmë që edhe komuna e Drenasit sa më shumë me pasë parasysh edhe të dhënat edhe raportet e këtij komiteti, për arsye se personat me aftësi në nevojë janë dhe kërkojnë ndihmën e shoqërisë për arretjtë të institucionit në komunë në këtë rast.

Miratohet lista e anëtarëve të Komitetit të Konsultativ Komunal për Komitetin për Personat me Aftësi të Kufizuar, në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve si vijon:

1. Lendita Elshani
2. Lonora Shala
3. Mirlindë Gashi Xhylani
4. Dëshira Berisha Morina
5. Antigona Bucolli
6. Indire Olluri Thaqi
7. Altesa Bytyqi

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e gjashtëmbëdhjetë të rendit të ditës: **16. Propozim për ndryshim-plotësimin e rregullores për taksa tarifa, ngarkesa dhe gjoba Nr. 02-400/01-57198 të datës 22.11.2023.**

**Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci:** Ne e kemi veç një gabim që na kanë kërku ata me përmirësu. Dy herë ua kena dërguar, Dy herë e kanë kthy në rregull. Tre të një herë kanë thënë duhet me përmirësu domethënë veç atë përmirësim kena me e ba.

Meqë nuk pati diskutime apo vërejtje tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës. prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar, “Për” votuan 26 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e shtatëmbëdhjetë të rendit të ditës: **17. Raporti i ekipit të Auditimit Social në Drenas.**

**Xheneta Murtezaj,** raportoj në kuadër të organizatës BIRN Kosova.

Për më shumë detaje mbledhjen e Kuvendit Komunal Drenas mund ta ndiqni edhe ne kanlin you tube shih linkun më posht.

[https://www.youtube.com/watch?v=o4vH9\\_AE2Pg](https://www.youtube.com/watch?v=o4vH9_AE2Pg)

**Kryetari Ramiz Lladrovci,** e falenderoj ekipin e auditimit social Drenas, të gjeturat e juve, rekomandimet e juve na bëjnë ma të përgjegjshëm me i kry punët në mënyrë më transparente dhe ma llogaridhënëse.

**Labinot Halilaj:**Unë veç dashta me ditë se si bëjmë përzgjedhjen e anketuesve ose qytetarëve në këtë ekip dhe sa janë, dhe opinionin tyre a janë shumë reale, opinionin është shumë real.

Përndryshe zani kritik gjithmonë bota civilizune ka ec gjithmonë në saje të kritikes.

Kritika është diçka që e përmirëson, qoftë qeverisjen lokale, qoftë Kuvendin, qoftë individin, qoftë kur ama kritika duhet me ka mirëfilltë.

**Xheneta Murtezaj:** të përzdhedhja e ekipit të auditimit social është ba në kuadër të ë BIRN-it dhe projektit DEMOS, të cilët e kanë arritë me i analizu qytetarët të cilët prej fushave të ndryshme, t'u përfshijë qytetarët të cilët janë ambientalistë, janë inxhinierë të fushave të inxhinierë të ndërtimtarisë, ish ë janë pensionistë e të fushave të ndryshme, duke përfshi një laramani të qytetarëve të thjeshtë.

Nuk kemi dashtë me pas qytetarë të cilët kanë pozita, ose janë qytetarë të cilët ndoshta nuk nuk kanë pozita të tjera, ose kemi dashtë me shku me qytetarë të cilët janë më të thjeshtë, të cilët edhe mënyra edhe në këtë formë që u ngrit edhe vetëdijesimi i tyre që me i mbikëqyrë projektet të cilat janë në komunitet.

Kështu që ekipi jonë ka dalë në terren edhe i kemi shku në pjesë të lagjeve ku është prek projekti, në Poklek të Ri, në Poklek të vjetër, Drenas, pra të rrjedha e lumit, të cilën ka qenë e përfshirë me projektin në fjalë, janë marrë qytetarët dhe kjo është rezultati i sotëm.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci:** Për plotësim, komuna nuk ka pas asnjë lloj ndikimi në përzgjedhjen e auditorëve ose e ekipit të auditimit social, pra Demos e ka përzgjedhë BIRN-in, BIRN-i ka punu me ekiye të ndryshme, të cilët edhe një herë i falënderoj.

**Mehedin Salihu:** sa kohë ka marrë ky auditim dhe sa persona janë intervistua ose janë pyet.

**Xheneta Murtezaj:** Po, kemi fillu prej muajit qershor deri në muajin nëntor është bërë monitorimi, janë dalë mbi dhjetë herë në terren, jemi taku bashkë me qytetarët, me ekipin e auditimit.

Nuk kemi dalë na në terren, ka dalë ekipi i auditimit social, na vetëm i kemi asistua, i kemi këshillua, i kemi tregu qysh bëhet auditimi social kështu që për fillim ka qenë kjo, kështu në vazhdim qytetarët, ekipi vetë e ka ditë punën e tij, është interesu vetë për projektin, ka dalë në terren, na ka informu çka u tut punu, kush u duke punua, a u dal menaxher i kontratës menaxher i projektit në terren, a ka sinjalizime, a është sinjalizuar të cilat mujnë me parandalu, të cilat e paralajmërojnë rrezikun në vendpunishte e të tjerë dhe kanë dërgu fotografi nga vendi i ngjarjes, në faqen e fundit të raportit është edhe lista me të gjithë qytetarët të cilët kanë marrë pjesë në auditimin social, kështu që këta kanë punu me neve edhe janë drejtu edhe komunës me mbi tre kërkesa, më shumë se tri kërkesa në dokumente publike, kanë kërku të dhëna prej komunës, kanë kërku projektin detaje kanë kërku me ditë nëse ka pas dëgjime publike për projektin në fjalë, e cila sipas edhe gjetjeve të auditimit ekipit është konstatu se Komuna e Drenasit nuk ka pas në diskutime konkrete konkrete për projektin, veçanërisht për projektin në fjalë, kështu që janë analizu edhe krejt dëgjimet publike që janë mbajt në Komunën e Drenasit në vitet e kalume, çka është diskutu, çka kanë pas kërkesat qytetare, sa kohën e nevojshme ky projektet etj

Ekipet tona kanë dalë në terren bashkë me menaxherin e kontratës, bashkë me kompaninë të cila i ka mena i ka kry punimet, ka bisedu edhe me qytetarët të cilët kanë qenë, të cilët jo domosdoshmërisht kanë qenë në kuadër të projektit, por kanë qenë qytetarë të cilët kanë dashtë me shprehje ose pakënaqësitë e tyre ose diçka të cilat janë marrë parasysh edhe të gjitha të gjitha rekomandimet qytetarëve, qoftë ato të cilët kanë kërku që përreth lumit mu ba shtigje për biçikleta, mu rregullu shtrati i lumit e të tjerë, kështu që numër të saktë u mundur me të dhënë, përveç kësaj, se për shkak të natyrës së projektit, të cilët a janë persona adekuatë me të cilët ë përgjegjës të cilët ë është dashtë me bisedu dhe kemi bisedu.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e tetëmbëdhjetë të rendit të ditës: **18. Raporti i vitit 2023 për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.**

Nuk pati diskutime, kaloj tek pika tjetër.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e nëntëmbëdhjetë të rendit të ditës: **19. Raporti vjetor i punës për vitin 2023 i Komitetit për Komunitete dhe Kthim.** Nuk pati diskutime, kaloj tek pika tjetër.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e njëzet të rendit të ditës: **20. Raporti vjetor i punës për vitin 2023 për Komitetin Konsultativ për Barazi Gjinore.**

Përfaqësuesi i Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore Arton Hasani raportoj për punën e komitetit për periudhën janar-dhjetor 2023.

Për më shumë detaje mbledhjen e Kuvendit Komunal Drenas mund ta ndiqni edhe ne kanlin you tube shih linkun më posht.

[https://www.youtube.com/watch?v=o4yH9\\_AE2Pg](https://www.youtube.com/watch?v=o4yH9_AE2Pg)

**Egzona Tërdevci:** E falënderoj shumë z.Hasani për raportimin dhe e përgëzoj publikisht se ka një përmirësim tepër të theksuar nga raportimi i vitit të kaluar edhe në prezantim, po edhe raporti është i hartuar shumë mirë.  
Faleminderit shumë për raportimin!

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e njëzet e një të rendit të ditës: **21. Të ndryshme.**

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci:** Megjithëse, nuk na dha rasti me mbajtje fjalim ose me falënderje të gjithë ata që morën pjesë në shpalljen e qytetarit nderi të katër heronjeve tonë, sot Drenasi ua jep një mirënjohje simbolike bijeve saj, ish-Presidentit Hashim Thaçi, Kryeparlamentarit të Kadri Veseli Jakup Krasniqi dhe Kryetarit të Grupit Parlamentar Rexhep Selimi.

Mirënjohja nuk ishte të bëjë me politikën, por ne këtu dëshmojmë se ata janë heronjë të luftës dhe paqes, ata janë edhe qytetarë të nderit të Drenasit, për atë që do të ekzistojnë si komunë. Historia lindi këtu në Drenicë dhe ne, me një simbolikë thjeshtë, duam t'ia japim lajmin se ata edhe si qytetarë nderi janë krenaria e kombit.

Sot jam shumë krenar, sepse dhamë së bashku me Asamblenë një titull, titull që flet se ata janë pjesë e jona, janë krenaria jonë, Hashim, Kadri, Jakup, Rexhep, megjithëse jeni me trup larg, ne ju kemi pranë sot e gjithmonë, ju çlirimtarë, ju lirisdashës, ju heronjë të luftës e paqes. Krenarë me Asamblesë dhe Asamblenë e komunës, lavdi ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, lavdi heronjeve, dëshmorëve e martirëve të lirisë!  
Faleminderit!

**Egzona Tërdevci:** z.Gllareva nuk është prezent, po megjithatë mundet me u përgjigj pyetjes në një në një kohë tjetër kur ajo sheh të përshatshme.  
Unë e kam adresuar më shumë se tre herë ndoshta rrugën në lagjen “Tërdevci” në fshatin Gllobar.

z. Gllareva publikisht më ka premtu që ka me përfundu brenda vitit 2023 .

Është shtrur një shtesë e zhavorit, po nuk kanë përfundu punimet.

Kërkoj që të ju rrinë mbrapa premtimit të vet dhe të përfundoj rruga para përfundimit të vitit.

**Milaim Hajdari Kryesues:** Sekretaria e evidenton, z.Gllareva, mos thotë në mbledhje e vjen tjetra, në besoj që jep përgjigje.

**Mehedin Salihu:** së pari e kam një një sugjerim, shumë pak po na jepni sqarime e propozime, i keni të shkruane ditën e mirë, janë njerëz përgjegjës që duhet me dhanë më shumë sqarime prej sa jna ardhë këtu.

Nëse na i kena shkru në raporte, atëherë s'po vijmë hiq, i lexojmë te shpija dhe s'i diskutojmë hiq. Kryetarit sot po i mungon anëtarët e Kabinetit. Nuk është edhe mirë, nuk është serioze kjo punë.

Të kam vetë njëqind herë ku na me iu drejtu ke fukë Gllarevës, Gllareva kurrkund s'po rrinë. Po e bëhem pak më serioz.

Unë kam dashtë, sepse zoti Gllareva i ka heq dy rrugë në fshatin tim, dy segmente domethënë kanë pas me u asfaltu ato janë këtu rregullune krejt.

Edhe më vjen keq që qytetarët po mendojnë që shkaku jem, aty rrugë janë anulë prej

asfaltimit.

Ajo kam dashtë me pyet Gllarevën me i kallëzu qytetarëve, të paktën qytetarëve që nuk është faji im, është faji i Gllarevës edhe atyre që merren me këtë punë pse janë hjek prej asfaltimit ky segment.

Ka edhe rrugë tjera, po seriozisht nëse s'është prezent ai i kryetarit tana nuk mundet me i ditë ato rrugë, për sa është edhe i zgjidhur naj për rrugët për për këto tjera sene.

Hajde, kryetar!

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci:** 70 % po mungon kabineti.

Po, kabinetin e kam këtu, sot është 27, është dita e fundit që i bëjmë pranim-dorëzimet e projekteve të punës edhe i bëjmë pagesat.

Unë jam i lumtur, përkundër që nja një muaja e dytë na e keni shtyë sheshin, kena mbërri me harxhu një pjesë të buxhetit edhe na ka mbet një pjesë me harxhu si rezultat i vonesave, zoti Gllareva është në punë intensive për ta shpenzu buxhetin sa më shumë që na me mbetë në garë për grant performancës për vitin që e kemi lanë, sigurisht që s'kena me marrë grantin e performancës, ju kam shpjegu, vendin e parë e morëm gjithsesi, por granti i performancës i ka edhe katër shtylla, kur njëri nuk e kalon, nuk e merr grantin, siç është raporti i auditorit, shkak të keqklasifikimit, si na kanë quajttë ata, të pasqyrave financiare, të pagave, të kontratave të shëndetësisë të arsimit e të tjera, na jena keqklasifiku.

Kësaj radhe jena shumë mirë, jam i lumtur, sepse komuna i fiton nja tre-katër milionë për këtë vit po vitin që e lamëna i kemi hapur nja tre-katër milionë edhe jua kam bo me dije që unë e kam paditë Ministrinë e Shëndetësisë edhe Ministrinë e Arsimit për shkak se si rezultat i gabimeve të tyre i kontratave kolektive që i kanë lidh pa zotimin e mjetevedhe në dëm të komunave, sigurisht që kom ja, kam thënë që kom ja shtu edhe pjesën e grantit që kishim me e fitu.

Nuk besoj që i ka hjek Endriti ose z.Gllareva ato dy segmente në katunin e juve, po sigurisht s'kanë mujt me u kry, sepse jo të gjitha punët kemi mujt me i kry.

Kena projekte prej 2012 Rruga "Kroni Mbretit" në Drenas, veç unë e di të zi të ullinit e kam mjek me mundu me përfundu dhe akoma nuk e kemi përfundu.

Kena projekte që i kena bast në fshatrat Koroticë, Vasilevë e tjera tjera, të cilat nuk i kanë kry operatorët fare për shkak të pandemisë, edhe përkundër që na me ligj na ka leju Qeveria me bo pagesa njëzet për qind, po as ato nuk i kanë dashtë edhe na kanë dëmtu.

Pra, qindra-mijëra euro na kanë humbë si rezultat edhe i pandemisë, po edhe i kompanive joserioze, siç i kemi edhe tash problemet e ndryshme.

Ju e dini që ne kemi pasur probleme edhe me rrjetin e ujës-jellësit, edhe me me bazenin e ujit të pijes në Kamenicë, i cili për mos me i humb edhe nja tre-katër vjet në gjykata, na kena hi me riparuar dhe hala s'po është i zoti kompania me riparuar, po lagen muret dhe na nuk mujt me dorëzuni diçka, i cili ka mbetë pa u kry, kështu që sikaton juve as nuk mund t'i akuzojnë njerëzit ty si ish-shkaktarë që nuk janë shtruar ato rrugë.

Nëse ju e përçoni këtë mesazh atje, nuk bëni mirë se nuk është ashtu, por domethënë kanë mbetë si rezultat sigurisht i mosarritjes së përmbushjes së planit.

**Mehedin Salihu:** Unë kërkoj prej kryetarit që ndoshta aq i nxënë nuk është, Endriti në mbledhje të ardhshme me me qenë pesë-gjashtë minuta edhe unë me argumentu këtë që po them, dhe nuk e besoj najherë që ke pasë opozitë më konstruktive si tani, kurrë pengu nuk të

ka, të ka dalë ndihmë sa herë ke pas nevojë, hiç nuk e besoj që kena bo pengesë najherë edhe jena në gjendje për të mirën e vendit me ba çka do të qoftë me bashkëapunu.

Për këto rrugë që po i cek unë, janë edhe disa rrugë që më kanë ardh në Lagjen "Qorri" në Shtrubullullë, janë duke argumentu nëse nuk po i flas kështu.

Qytetarët e fshatit Shtuticë më kanë thotë se unë nja dy-tri herë e kam kritiku z.Gllareva Edhe prap ka me kritiku, edhe ata kanë mendu që shkakun që unë po e kritikoj na ka penalizu.. E nëse z.Gllareva ndihet i sigurt që s'është ashtu, munet me dokumentu kjo shumë lehtë në seancën e ardhshme.


**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci:** për opozitë konstruktive, mendoj që për të disa pika nuk keni qenë, po në shumicën e rasteve jeni, Ju falënderoj për ata.

**Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur seancën, seanca përfundoj rreth orës 11:45 min.**

*Me gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 27.12.2023 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të komunës, rrjetin social të Facebook-ut dhe në kanalin YouTube.*

[https://www.youtube.com/watch?v=o4yH9\\_AE2Pg](https://www.youtube.com/watch?v=o4yH9_AE2Pg)

Procesmbajtëse:



Liridona Fejza-Ajazi

Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Milaim Hajdari





Republika e Kosovës  
Komuna e Drenasit  
Kuvendi i Komunës



02Nr. 334/05-3963 dt. 22/01/2024

## PROCESVERBALI

Të mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: **27.12.2023**  
e cila filloi në orën 10:00.

### Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari

**Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 30 anëtarë:** Labinot Halilaj (PDK), Bekim Lestrani (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Blerina Gashi (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Qendrim Mulaj (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Blerina Gashi (PDK), Albulena Saliuku (PDK), Valentina Leku (PDK), Manushaqe Mulaku (PDK), Mirlinda Dvorani (PDK) Sali Dvorani (DD), Mergim Pirraku (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Florentina Elezi-Veliu (VV), Filloreta Bujupi (VV), Drin Halilaj (VV), Egzona Terrdevci (VV), Muhamet Kurtaj (VV), Arbër Halilaj (GREEN), Beqir Kiqina (AAK), Egzon Qorri (LDK). Sali Dvorani (DD). **Mungoi Muhamet Kurtaj.**

Të pranishëm ishin edhe **Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, Nënkryetari Arben Shala, Drejtor të Drejtorive komunale, përfaqësues të KFOR-it zyra e informimit, qytetar dhe Xheneta Murtezaj për Raportim të ekipit të Auditimit Social në Drenas**

Mbledhja filloi punimet me këtë rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Komunal i datës 22.11.2023.
2. Propozim vendim për shpalljen e z. Hashim Thaqi "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit.
3. Propozim vendim për shpalljen e z. Kadri Veseli "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit.
4. Propozim vendim për shpalljen e z. Jakup Krasniqi "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit.
5. Propozim vendim për shpalljen e z. Rexhep Selimi "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit.
6. Plani i Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2024.
7. Plani vjetor i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024.
8. Lista e Rreziqeve Komunale për vitin 2024.
9. Propozim vendim për financim të projektit në projektin e Jehona Hoxha.
10. Propozim për ndryshimin/korrigjimin të vendimit për financimin e projektit Drilona Krasniqi.
11. Propozim për ndryshimin/korrigjimin të vendimit për financimin e projektit Sabahate Gashi.

12. Propozim për ndryshimin/korrigjimin të vendimit për financimin e projektit Doruntina Shehu.
13. Lista me anëtarët për Komitetin Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport i propozuar nga paneli përzgjedhës nga Kuvendi Komunal Drenas.
14. Lista me anëtarët për Komitetin Konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale nga paneli përzgjedhës nga Kuvendi Komunal Drenas.
15. Lista me anëtarët për Komitetin Konsultativ për Komiteti për Personat me Aftësi të Kufizuar i propozuar nga paneli përzgjedhës nga Kuvendi Komunal Drenas.
16. Propozim për ndryshim-plotësimin e rregullores për taksa tarifa, ngarkesa dhe gjoba Nr. 02-400/01-57198 të datës 22.11.2023.
17. Raporti i ekipit të Auditimit Social në Drenas.
18. Raporti i vitit 2023 për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
19. Raporti vjetor i punës për vitin 2023 i Komitetit për Komunitete dhe Kthim.
20. Raporti vjetor i punës për vitin 2023 për Komitetin Konsultativ për Barazi Gjinore.
21. Të ndryshme.

Mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Drenasit u mbajt me dt. 27.12.2023, ku për diskutim ishin 21 pika për rend dite. Mbledhja është kryesuar nga kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari. Kryesuesi hapi punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal ku njoftoi me rendin e ditës e lartcekur.

Meqë nuk pati diskutime apo vërejtje tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, “Për” votuan 29 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua rendi i ditës me pikat e lartcekura.

**Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

**1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 22.11.2023.**

Meqë nuk pati diskutime apo vërejtje tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, “Për” votuan 28 anëtar, kundër nuk pati, 1 abstenim, u miratua procesverbali i mbledhjes së rregullt të KK i mbajtur më dt. 22.11.2023

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, **Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Propozim vendim për shpalljen e z. Hashim Thaqi “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.**

**Egzona Tërdevci:** Para votimit të këtyre pikave janë disa çështje që dua t'i diskutoj.

Edhe unë, si shumë fëmijë të tjerë të Kosovës, kam pas fatin e keq të lind në një vend të pushtuar e të rritem në kohë lufte.

Gjenerata ime dhe shumë gjenerata tjera më pas, janë rritë me dashni e admirim për Ushtrinë tonë Çlirimtare e heronjtë e vendit tonë.

Është e trishtueshme që në kohën kur ne po diskutojmë për ta pikërisht ata që luftuan për lirinë tonë, të mos kenë mundësinë ta shijojnë atë, por të akuzohem se mbrojtëm vendin e tyre me dinjitet, duke mos dashur të bëj asnjë deklaram që do të mund t'i dëmtonte ndonjërin prej tyre, e ndjej për obligim t'i ngris disa dilema rreth këtyre propozimeve.

Zotëri Lladrovci, po të kërkoj emrin tuaj dhe emrin e personave që sot shpallen qytetarë

nderi, ndër lajmet e para janë akuzat që ju keni bërë ndaj tyre pikërisht për çështje të luftës. Është hipokrizi që sot për poena politike ta sillni një propozim të tillë, kur në kohë jo shumë të largët ata kanë marrë akuzat nga vetë ju, më e pakta që mund të bëni para këtyre votimeve është të kërkonin falje nga ta dhe nga të gjithë të tjerët që janë ndikuar nga akuzat e juaja drejt tyre.

Është paradoksale që njerëzit që vetë i keni akuzuar t'i propozoni t'i shpallni qytetarë nderi sot, të paktën jo pa pranuar gabimet tuaja të se kaluarës në raport me ata dhe pa kërkuar falje. Është edhe një çështje tjetër të këto propozime nëse duam të shpallim të vlerësojmë mirënjohje e të shpallim një vlerësim për personat që po e ndajnë këtë titull, do të duhej që neni dy, pra arsyeja pse e ndajnë këtë titull të ishte i njëjtë për të gjithë, e në veçanti shqetësues është propozimi tek pika katër për z.Krasniqi.

Më lejoni ta citoj këtë nen nga propozimi që na e keni sjellë.

Titulli qytetar nderi për z. Jakup Krasniqi i jepet për kontributin e tij në shtet formim dhe shtet ndërtim dhe proceset historike që ka kaluar Kosova, Tek propozimi për shpalljen e tij qytetar nderi nuk përmendet fare pjesa për kontributin e tij në luftën çlirimtare.

Uroj që ky gabim të jetë veç pasojë e neglizhencës, sepse me gjithë mllëfin që keni shfaqur për të në periudha të ndryshme nuk dua të besoj që keni aq dashakeqësi sa ta mohoni kontributin e luftë.

Me gjithë këto vërejtje, në emër të Grupit të Lëvizjes Vetëvendosje, potencoj edhe një herë se nuk jemi, e as nuk kemi qenë asnjëherë kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e as kundër historisë tonë të lavdishme për çlirim e pavarësi.

Si grup i asamblistëve të Lëvizjes Vetëvendosje, ne do të votojmë pro këtyre propozimeve, duke shprehur mirënjohjen për kontributin e secilit nga bashkatdhetarët tanë që gjendet në Hagë. Gjithësi konsiderojmë që në një situatë të tillë ju do të përmirësoni gabimet karshi tyre duke kërkuar falje publikisht për akuzat tuaja por dhe do ta përmirësoni gabimin tek pika katërt.

**Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovi:** Për asnjë gjë në botë unë deri sot që e kam bërë nuk kam nevojë me kërku falje dhe nuk kërkoj falje.

Nuk du me prish këtë solemnitët, sepse ata janë katër djem drenicak, të cilët na kanë bërë krenarë,në shumë situata, si në themelimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si në themelimin e shtetit të Kosovës, më vjen keq që disa provojnë këtë solemnitët me e prishë.

Nuk muni me e prishë, as s'keni mujt kurrë me e prishë.

Unë jam kanë edhe në vizitë tek ata, më keni shpallë edhe dëshmitarë të Hagës, po as njana as tjetra nuk ka ekzistë dhe nuk ka me ekzistë kurrë.

Vullneti i qytetarëve të Drenasit është që heronjtë e tyre të luftës e të paqes t'i kanë qytetarë nderi të komunës së vet, pra të komunës së Drenasit.

Na si regjion jemi-Drenicë, edhe drenicakët e vet do me i pasa qytetarë nderi.

Unë e kam bo veç një propozim të vullnetit të shumicës të qytetarëve nderit.

Ne e dallojmë kundërshtitë politike me çështjet që kanë të bëjnë që janë fundamentale.

As unë pa dashtë me ndërhyrë në çështje të cilat unë nuk jam i thirrur me i dëmtu, po jam i thirrur me ndihmu si proces, sepse procesi nuk bëhet përkatë djemtë Drenicës, po bëhet për Kosovën edhe unë jam shumë i bindur që ata do të kthehen fitimtarë.

**Egzona Tërdevci:** veç në diçka pajtohna me juve dhe unë du me i pa ata katër njerëz të kthy fitimtarë, sepse fitore e tyre është fitore e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, rrjedhimisht është edhe e shtetit tonë.

Për të mos me dash me prishë këtë seancë solemne, insistoj që veç te pika e katërt me u ba përmirësimi edhe të katërtit të nderohen për kontributin në luftë, ndoshta është gabim teknik por kërkoj ta përmirësoni.

Meqë nuk pati diskutime apo vërejtje tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, “Për” votuan 29 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim vendim për shpalljen e z. Kadri Veseli “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.**

Meqë nuk pati diskutime apo vërejtje tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, “Për” votuan 29 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati u miratua kjo pikë e rendit të ditës

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: **4. Propozim vendim për shpalljen e z. Jakup Krasniqi “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.**

**Egzona Tërdevci:** propozoj që të ndryshohet neni dy, pra pika ku njihet kontributi i tij, të përmendet edhe kontributi i tij në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

**Ramiz Lladovci Kryetar i Komunës:** Nuk i mohohet askujt kontributi për asnjë gjë dhe nuk ju ka mohua as aty, as pikën dy, as pikën tre, ata shpallën heronjtë qytetarë nderi të komunës qytetarë të njëjtë, të barabartë.

Meqë nuk pati diskutime apo vërejtje tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, “Për” votuan 29 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Propozim vendim për shpalljen e z. Rexhep Selimi “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.**

Meqë nuk pati diskutime apo vërejtje tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, “Për” votuan 29 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Plani i Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2024.**

**Egzona Tërdevci:** janë disa propozime që ne i kemi lidhur me planin e punës.

Nëse e ngritni si dilemë se nuk i kemi dërgu me shkrim, nuk i kemi dërgu se edhe kur po i dërgojmë, më herët nuk është që po merrem parasysh, po po dojmë me shtrë këtu për diskutim para të gjithë juve.

Në janar të shtohet edhe prezantimi para asamblesëve në detaje për planin e prokurimit për vitin 2024.

E dimë që një dokument i tillë është publik në faqe të komunës, por kur po diskutojmë për buxhetin, sepse nuk po bahet një ndarje më e qartë e projekteve, gjithmonë po na thuhet që është një plan i brendshëm, le të vjen ai plan i brendshëm dhe le të prezantohet para

asamblesë.

Në janar po ashtu të shtohet raportimi lidhur me dhënien e pronave në shfrytëzim për të gjitha pronat që janë në shfrytëzim afatgjatë, që janë dhënë përgjatë këtij mandati, këtë pikë e kemi kërku edhe në seancat tjera, po na shton që nuk keni mundësi për shkak se e keni zyrtarin në pushim me u përgatitë, konsideroj që në janar është koha e mjaftueshme për me u përgatitë. Në shkurt dhe në mars është paraparë të trajtohet plani i transparencës, konsiderojmë që një plan i tillë mjafton të trajtohet në një seancë të vetme, pra vlerëson jo nëse është më e drejtë të trajtohet në shkurt apo në mars.

Në maj ose varësisht nga fakti se si mund të organizohen drejtoritë, të sillet raport në Kuvend Komunal për të gjitha subvencionet që janë ndarë nga Kuvendi për vitin paraparak.

Në korrik, kur diskutohet raporti nga Zyra Kombëtare e Auditimit në korrik të raportojnë të gjitha drejtoritë që kanë buxhet për investime kapitale lidhur me realizimin e investimeve kapitale.

Në korrik të bëhet një rishikim i planit të punës për kuvendin e komunës dhe varësisht nga plani të ri-planifikohet pjesa tjetër e vitit.

Në korrik po ashtu të prezantohet edhe raporti financiar gjashtëmuor, i cili në planin aktual është i planifikuar të prezantohet në shtator dhe konsiderojmë që në korrik është mjaftushëm kohë e përshtatshme për t'u përgaditur. Në nëntor, kur është paraparë, të raportojnë disa drejtori lidhur me investimet kapitale, të raportojnë të gjitha ato që kanë buxhet të destinuar për investime kapitale, e jo vetëm ato që janë cekur në plan.

Nga viti 2021, kur ne si legjislaturë e kemi bërë betimin si asamblesë, ne çdo herë kemi pasur në plan pune njëmbëdhjetë seanca, por i kemi mbajtur nga dymbëdhjetë.

Pra, prej vitit 2022-2023, ne kemi mbajtur seanca edhe në gusht të definohet kjo pjese nese planifikoni ti keni 12 ateherë t'i kemi edhe në plan të punës ashtu. Në qershor shtator, varësisht nga koha se si mund të përgatitet ekzekutivi, të ketë një raportim për gjashtëmuorin e funksionimit të ndërmarrjes lokale Stacioni i autobusëve Sha-Drenas, pasi e kemi nda kapitalin edhe kam pa që shpall edhe konkursi, po besoj që kompania shpejtë fillon punën.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci:** raportet që i kanë parapame me ligj, as unë i shton ti, as nuk mund t'i heq ti.

Nëse raportin financiar për gjashtë muor e ke na në muajin e shtatë, e bëjmë muajin e shtatë, se s'mujna pa i marrë raportet e fribalancit, na nuk mujna me raportu.

**Kryesuesi i Kuvendit Milaim Hajdari:** Unë konsideroj që pjesa dërmuese e çështjeve që ngritjek zonat janë në planin e punës, janë në planin e punës ose më mirë me thënë janë forma të ndryshme të shkronja të ndryshme, po përfshijnë.

Megjithatë, ajo çka është e mundshme do të thotë me inkorporu në plan të punës, na e inkorporojmë, besoj se Sekretaria i ka marrë këtoKështu që nuk kemi ndonjë telashe lidhje me këto, për çështje që që mendojmë që janë të drejta për t'u diskutu ose për t'u plotësu, megjithatë ne jemi Kuvendi këtu çdo muaj dhe për secilën çështje kemi të drejtë me ngritë, do të thotë paraprakisht probleme e radhës.

**Egzona Tërdevci:** Nëse në prill është e mundur të prezantohet raporti financiar, po po mujka me u bë mbyllja brenda një muaji, pse nuk mund edhe në korrik me u ba raporti por deri në qershor.

S'ka logjikë me thanë që s'mundet me u përgatitë, se mundet, po nëse ju e vlerësoni që duhet me kanë shtatori, e rëndësishme me ardhë raporti, unë si Asambleistë e kërkoj që të hidhen

propozimet tona në votim nëse i marrim votat, pra se inkorporohen në plan, nëse nuk i marrim votat megjithatë e vlerësoni ju.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci:** Pra, afatet ligjore as m'i ndrron ti, as Kuvendi e as askush, sepse janë afate ligjore që i ka parapare niveli qendror, për raportim financiar. Për raportim për dënimin e pronave është galë raportit. Mund edhe sot të ndryshme me raportu, nuk kemi asnjë lloj problemi.

**Labinot Halilaj:** Ky është propozim, plani i punës. Zakonisht kur të bohet plani i punës, ajo sigurisht që nuk bëhet edhe me deri detajet e fundit, po është ajo plani i punës, vija e trasha, është plani i punës edhe kur të bëhet plani i punës nuk është që plani i punës të bëhet edhe deri në detaje. Ka mundësi që domethënë shumë herë edhe plani i punës me i ikë tema që njëfarë mënyre që janë në interes edhe të Kuvendit po edhe të ekzekutivit për mu diskutu. Po ato mujn me u inkorporu edhe gjatë periudhës kur kena seancë nuk është që eventualisht domethënëse s'mundet asni plan i Kuvendit, edhe na me ka pjesë e hartimit të tina që me i përfshijë të gjitha temat që kam për diskutim. Nëse eventualisht, domethënë ne nuk jemi të inkorporum në këtë plan, bëjmë seanca të tjera, mundet me e inkorporu ne vetë, mundet me ndryshu planin. Në janar në seancë, në janar mundet me diskutu edhe një plan që me i shtu edhe këtu, me i shtu edhe këtu. Vija e trasha votohet ky plan edhe mandej s'është telashe. Ne s'mundemi me bo raportim sipas dëshirës, janë afatet ligjore, na s'munda me votu në diçka që është kundërshtim me ligjin.

**Beqir Kiqina:** Kisha propozu kryesuesit që në këtë rast mu merr me planin e punës edhe herave të tjera me thirr do të thotë shefat e grupeve kuvendare ose përfaqësuesit domethënë të subjekteve politike shefat e grupit, në mënyrë që mu konsultu për planin e punës, e pse jo mujna me bo edhe një plotësim-ndryshim ndoshta edhe në fillim të vitit të ardhshëm edhe mu konsultu për planin e punës, sepse plotësi-ndryshimet lejohen me Rregulloren e Kuvendit.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci:** sot duhet ta votojmë, sepse është thirrje e sqaroi Labinoti fort mirë prapë po themmua nuk u takon me u përzi në planin e juaj, por edhe një herë po jua kujtoj, propozimi i parë qitet, propozimi i juaj, pastaj i dyti.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari,** çdo seancë, anëtarët e Kuvendit kanë të drejtë me ba propozime për çështje të caktura që ju interesojnë. Dhe nuk e di cili është nuk e di cili është nuk e di cili është halli do të thotë që me bo kaq të madhe këtë punë. Unë e thashë Fillimisht, e thashë me modestinë ma të madhe, ne e kemi bërë një thirrje për punëtori, pikërisht për të diskutu, për të mbyllë debatin kur të vijmë ne këtu me ardhë e qartë në lidhje me planin e punës. Edhe në janar domethënë ulemi grupet parlamentare e diskutojmë, merrreni vesht çka ka mundësi me inkorporu në plan punës grupet parlamentare do të thotë i bëjna pjesë e planit të punës.

**Egzona Tërdevci:** është e padrejtë me thanë që s'po pajtohemi, po diskutojmë kot, se nuk është diskutim kot diskutimi për planin e punës. Në rregull, nëse është me të vërtetë përcaktim ligjor, po po pajtohem që pjesën pikën për

raportin financiar unë po e tërheq në emër të Asambleve Vetëlvizjes Vetëvendosje, silleni sipas planit të punës.

Po nuk mundesh me thanë që qitet në fillim propozimi juaj në votim, pastaj joni, se na Ne jemi tu bo amendament në planin e punës që e kemi marrë.

Nuk e kuptoj çfarë shton kjo frikë, çfarë shton ky hezitim me i qitë propozimet tona në votim. Asnjë propozim i joni si asamblesë nuk është tu u qitë në votim.

Ju lutna, respektoni Rregulloren, respektoni ligjin, jepna të drejtën si asamblesë t'i hedhni në votim propozimet tona, nëse nuk kalojnë na nuk mundemi me i marrë votat me zor.

Thjesht, hidhni votim propozim-ndryshimin.

Para se të hidhet komplet plani i punës, i merr votat propozim-ndryshime që i kemi ba, e votojmë planin të tillë me propozimet tona.

Nuk i merr votat, hidhe në votim propozimin tjetër, po nuk mundesh me krahasu se na nuk kemi dërgu komplet plan të punës.

Na jemi tu propozu veç ndryshime shtesë, pa pjesën për raportim financiar të gjashtë mujor, të cilin po e tërheki duke i respektuar afatet ligjore, edhe pse jam shumë e bindur që mundet me u bë në korrik, po nuk po du me e zgjat më shumë këtë temë.

Atë pikë e tërhekun pikat tjera, ju lus që t'i hedhim votim, sepse është e drejtë e jona si asamblistë që japim propozime dhe të njëjtat të hidhen votim.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari:** unë e kisha propozu që në janar do të bëhen përfaqësues të grupeve parlamentare të diskutojnë edhe do të me gjete ata të gjuhë të mirëkuptimit, mirëpo pjesë me inkorporu.

Meqë nuk pati diskutime apo vërejtje tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, “Për” votuan 29 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: **7. Plani vjetor i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024.**

Meqë nuk pati diskutime kaloj tek pika tjetër.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: **8. Lista e Rreziqeve Komunale për vitin 2024.**

Meqë nuk pati diskutime kaloj tek pika tjetër

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës: **9. Propozim vendim për financim të projektit në projektin e Jehona Hoxha**

Meqë nuk pati diskutime apo vërejtje tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar, “Për” votuan 27 anëtar, kundër nuk pati, 1 abstenim u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dhjetë të rendit të ditës: **10. Propozim për ndryshimin/korrigjimin të vendimit për financimin e projektit Drilona Krasniqi.**

**Egzona Tërdevci:**Nëse na kishin ardh materialet kur na i kemi kërku si asamblesë për këto subvencione, ndoshta ishin evitu me kohë ky gabim, po keni zgjedhë me mbajë qeverisjen të mbyllne dhe me i bo sendet ad hok e në mënyrën më të keqe qysh jeni mësu, na nuk i mbështetim këto propozime, sepse nëse kishin ardhë me kohë materialet kishim mujt me evitua këto gabime.

Meqë nuk pati diskutime apo vërejtje tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar, “Për” votuan 26 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës: **11. Propozim për ndryshimin/korrigjimin të vendimit për financimin e projektit Sabahate Gashi.**

Meqë nuk pati diskutime apo vërejtje tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 22 anëtar, “Për” votuan 22 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës: **12. Propozim për ndryshimin/korrigjimin të vendimit për financimin e projektit Doruntina Shehu.**

Meqë nuk pati diskutime apo vërejtje tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 22 anëtar, “Për” votuan 22 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës: **13. Lista me anëtarët për Komitetin Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport i propozuar nga paneli përzgjedhës nga Kuvendi Komunal Drenas.**

Miratohet lista e anëtareve të Komitetit të Konsultativ Komunal për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, në përbërje prej pesë (5) anëtarëve si vijon:

1. Leordita Shabani
2. Avni Mehani
3. Teuta Gashi
4. Lulzim Ademi
5. Xhensika Gashi

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e katërbëdhjetë të rendit të ditës: **14. Lista me anëtarët për Komitetin Konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale nga paneli përzgjedhës nga Kuvendi Komunal Drenas.**

Miratohet lista e anëtarëve të Komitetit të Konsultativ Komunal për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në përbërje prej pesë (5) anëtarëve si vijon:

1. Betim Morina
2. Lirie Bardhi
3. Arbenitë Rama
4. Qëndresë Bardhi
5. Xheneta Hoxha

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pesëmbëdhjetë të rendit të ditës: **15. Lista me anëtarët për Komitetin Konsultativ për Komiteti për Personat me Aftësi të Kufizuar i propozuar nga paneli përzgjedhës nga Kuvendi Komunal Drenas.**

**Beqir Kiqina:** Sa i përket pikës së pesëmbëdhjetë për të kandidatët për Komitetin Konsultativ për Aftësuar për persona me aftësi të kufizuar, Unë konkretisht kisha dashtë me falënderu Komisionin, i cili e paska ba një vlerësim të mirë, për arsye se rrallëherë në këto pika përmendet Komisioni dhe duhet të përmendet, për arsye se këtu është inkorporu edhe një përfaqësues i organizatës humanitare e quajtur Hendikës që më herët ka mungu dhe po mendoj që është një ndër institucionet më kompetente dhe relevante në Komunën e Drenasit që mundet me dhanë kontributin e vet, do të thotë në këtë komision dhe i përgëzoj edhe komisionin për një përzgjedhje të tillë dhe shpresoj sepse është një komitet një komitet i cili e ka një vendësi dhe është shumë specifik dhe shpresojmë që edhe komuna e Drenasit sa më shumë me pasë parasysh edhe të dhënat edhe raportet e këtij komiteti, për arsye se personat me aftësi në nevojë janë dhe kërkojnë ndihmën e shoqërisë për arretje të institucionit në komunë në këtë rast.

Miratohet lista e anëtarëve të Komitetit të Konsultativ Komunal për Komitetin për Personat me Aftësi të Kufizuar, në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve si vijon:

1. Lendita Elshani
2. Lonora Shala
3. Mirlindë Gashi Xhylani
4. Dëshira Berisha Morina
5. Antigona Bucolli
6. Indire Olluri Thaqi
7. Altesa Bytyqi

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e gjashtëmbëdhjetë të rendit të ditës: **16. Propozim për ndryshim-plotësimin e rregullores për taksa tarifa, ngarkesa dhe gjoba Nr. 02-400/01-57198 të datës 22.11.2023.**

**Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci:** Ne e kemi veç një gabim që na kanë kërku ata me përmirësu. Dy herë ua kena dërguar, Dy herë e kanë kthi në rregull. Tre të një herë kanë thënë duhet me përmirësu domethënë veç atë përmirësim kena me e ba.

Meqë nuk pati diskutime apo vërejtje tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 26 anëtar, “Për” votuan 26 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e shtatëmbëdhjetë të rendit të ditës: **17. Raporti i ekipit të Auditimit Social në Drenas.**

**Xheneta Murtezaj,** raportoj në kuadër të organizatës BIRN Kosova.

Për më shumë detaje mbledhjen e Kuvendit Komunal Drenas mund ta ndiqni edhe ne kanlin you tube shih linkun më posht.

[https://www.youtube.com/watch?v=o4yH9\\_AE2Pg](https://www.youtube.com/watch?v=o4yH9_AE2Pg)

**Kryetari Ramiz Lladrovci,** e falenderoj ekipin e auditimit social Drenas, të gjeturat e juve, rekomandimet e juve na bëjnë ma të përgjegjshëm me i kry punët në mënyrë më transparente dhe ma llogaridhëse.

**Labinot Halilaj:**Unë veç dashta me ditë se si bëjmë përzgjedhjen e anketuesve ose qytetarëve në këtë ekip dhe sa janë, dhe opinionin tyre a janë shumë reale, opinionin është shumë real.

Përndryshe zani kritik gjithmonë bota civilizune ka ec gjithmonë në saje të kritikes. Kritika është diçka që e përmirëson, qoftë qeverisjen lokale, qoftë Kuvendin, qoftë individin, qoftë kur ama kritika duhet me ka mirëfilltë.

**Xheneta Murtezaj:** të përzdhedhja e ekipit të auditimit social është ba në kuadër të BIRN-it dhe projektit DEMOS, të cilët e kanë arritë me i analizu qytetarët të cilët prej fushave të ndryshme, t'u përfshijë qytetarët të cilët janë ambientalistë, janë inxhinierë të fushave të inxhinierë të ndërtimtarisë, ish ë janë pensionistë e të fushave të ndryshme, duke përfshi një laramani të qytetarëve të thjeshtë.

Nuk kemi dashtë me pas qytetarë të cilët kanë pozita, ose janë qytetarë të cilët ndoshta nuk nuk kanë pozita të tjera, ose kemi dashtë me shku me qytetarë të cilët janë më të thjeshtë, të cilët edhe mënyra edhe në këtë formë që u ngrit edhe vetëdijesimi i tyre që me i mbikëqyrë projektet të cilat janë në komunitet.

Kështu që ekipi jonë ka dalë në terren edhe i kemi shku në pjesë të lagjeve ku është prek projekti, në Poklek të Ri, në Poklek të vjetër, Drenas, pra të rrjedha e lumit, të cilën ka qenë e përfshirë me projektin në fjalë, janë marrë qytetarët dhe kjo është rezultati i sotëm.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci:** Për plotësim, komuna nuk ka pas asnjë lloj ndikimi në përzgjedhjen e auditorëve ose e ekipit të auditimit social, pra Demos e ka përzgjedhe BIRN-in, BIRN-i ka punu me ekiye të ndryshme, të cilët edhe një herë i falënderoj.

**Mehedin Salihu:** sa kohë ka marrë ky auditim dhe sa persona janë intervistua ose janë pyet.

**Xheneta Murtezaj:** Po, kemi fillu prej muajit qershor deri në muajin nëntor është bërë monitorimi, janë dalë mbi dhjetë herë në terren, jemi taku bashkë me qytetarët, me ekipin e auditimit.

Nuk kemi dalë na në terren, ka dalë ekipi i auditimit social, na vetëm i kemi asistuar, i kemi këshilluar, i kemi treguar qysh bëhet auditimi social kështu që për fillim ka qenë kjo, kështu në vazhdim qytetarët, ekipi vetë e ka ditë punën e tij, është interesu vetë për projektin, ka dalë në terren, na ka informuar çka u tut punu, kush u duke punuar, a u dal menaxher i kontratës menaxher i projektit në terren, a ka sinjalizime, a është sinjalizuar të cilat mujnë me parandalu, të cilat e paralajmërojnë rrezikun në vendpunishte e të tjerë dhe kanë dërgu fotografi nga vendi i ngjarjes, në faqen e fundit të raportit është edhe lista me të gjithë qytetarët të cilët kanë marrë pjesë në auditimin social, kështu që këta kanë punu me neve edhe janë drejtu edhe komunës me mbi tre kërkesa, më shumë se tri kërkesa në dokumente publike, kanë kërku të dhëna prej komunës, kanë kërku projektin detaje kanë kërku me ditë nëse ka pas dëgjime publike për projektin në fjalë, e cila sipas edhe gjetjeve të auditimit ekipit është konstatu se Komuna e Drenasit nuk ka pas në diskutime konkrete konkrete për projektin, veçanërisht për projektin në fjalë, kështu që janë analizu edhe krejt dëgjimet publike që janë mbajtur në Komunën e Drenasit në vitet e kalime, çka është diskutu, çka kanë pas kërkesat qytetare, sa kohën e nevojshme ky projektet etj

Ekipet tona kanë dalë në terren bashkë me menaxherin e kontratës, bashkë me kompaninë të cila i ka menaxherin i ka kry punimet, ka bisedu edhe me qytetarët të cilët kanë qenë, të cilët jo domosdoshmërisht kanë qenë në kuadër të projektit, por kanë qenë qytetarë të cilët kanë dashtë me shprehje ose pakënaqësitë e tyre ose diçka të cilat janë marrë parasysh edhe të gjitha të gjitha rekomandimet qytetarëve, qoftë ato të cilët kanë kërku që përreth lumit mu ba shtigje për biçikleta, mu rregullu shtrati i lumit e të tjerë, kështu që numër të saktë u mundur me të dhënë, përveç kësaj, se për shkak të natyrës së projektit, të cilët a janë persona adekuatë me të cilët ë përgjegjës të cilët ë është dashtë me bisedu dhe kemi bisedu.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e tetëmbëdhjetë të rendit të ditës: **18. Raporti i vitit 2023 për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.**

Nuk pati diskutime, kaloj tek pika tjetër.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e nëntëmbëdhjetë të rendit të ditës: **19. Raporti vjetor i punës për vitin 2023 i Komitetit për Komunitete dhe Kthim.** Nuk pati diskutime, kaloj tek pika tjetër.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e njëzetë të rendit të ditës: **20. Raporti vjetor i punës për vitin 2023 për Komitetin Konsultativ për Barazi Gjinore.**

Përfaqësuesi i Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore Arton Hasani raportoj për punën e komitetit për periudhën janar-dhjetor 2023.

Për më shumë detaje mbledhjen e Kuvendit Komunal Drenas mund ta ndiqni edhe ne kanlin you tube shih linkun më posht.

[https://www.youtube.com/watch?v=o4vH9\\_AE2Pg](https://www.youtube.com/watch?v=o4vH9_AE2Pg)

**Egzona Tërdevci:** E falënderoj shumë z.Hasani për raportimin dhe e përgëzoj publikisht se ka një përmirësim tepër të theksuar nga raportimi i vitit të kaluar edhe në prezantim, po edhe raporti është i hartuar shumë mirë.  
Faleminderit shumë për raportimin!

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e **njëzet e një** të rendit të ditës: **21. Të ndryshme.**

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci:** Megjithëse, nuk na dha rasti me mbajtje fjalim ose me falënderje të gjithë ata që morën pjesë në shpalljen e qytetarit nderi të katër heronjve tonë, sot Drenasi ua jep një mirënjohje simbolike bijeve saj, ish-Presidentit Hashim Thaçi, Kryeparlamentarit të Kadri Veseli Jakup Krasniqi dhe Kryetarit të Grupit Parlamentar Rexhep Selimi.

Mirënjohja nuk ishte të bëjë me politikën, por ne këtu dëshmojmë se ata janë heronjë të luftës dhe paqes, ata janë edhe qytetarë të nderit të Drenasit, për atë që do të ekzistojnë si komunë. Historia lindi këtu në Drenicë dhe ne, me një simbolikë thjeshtë, duam t'ia japim lajmin se ata edhe si qytetarë nderi janë krenaria e kombit.

Sot jam shumë krenar, sepse dhamë së bashku me Asamblenë një titull, titull që flet se ata janë pjesë e jona, janë krenaria jonë, Hashim, Kadri, Jakup, Rexhep, megjithëse jeni me trup larg, ne ju kemi pranë sot e gjithmonë, ju çlirimtarë, ju lirisdashës, ju heronjë të luftës e paqes. Krenarë me Asamblesë dhe Asamblenë e komunës, lavdi ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, lavdi heronjve, dëshmorëve e martirëve të lirisë!  
Faleminderit!

**Egzona Tërdevci:** z.Gllareva nuk është prezent, po megjithatë mundet me u përgjigj pyetjes në një në një kohë tjetër kur ajo sheh të përshtatshme.

Unë e kam adresuar më shumë se tre herë ndoshta rrugën në lagjen “Tërdevci” në fshatin Gllobar.

z. Gllareva publikisht më ka premtu që ka me përfundu brenda vitit 2023 .

Është shtrur një shtesë e zhavorit, po nuk kanë përfundu punimet.

Kërkoj që të ju rrinë mbrapa premtimit të vet dhe të përfundoj rruga para përfundimit të vitit.

**Milaim Hajdari Kryesues:** Sekretaria e evidenton, z.Gllareva, mos thotë në mbledhje e vjen tjetra, në besoj që jep përgjigje.

**Mehedin Salihu:** së pari e kam një një sugjerim, shumë pak po na jepni sqarime e propozime, i keni të shkruane ditën e mirë, janë njerëz përgjegjës që duhet me dhanë më shumë sqarime prej sa jna ardhë këtu.

Nëse na i kena shkru në raporte, atëherë s'po vijmë hiq, i lexojmë te shpija dhe s'i diskutojmë hiq. Kryetarit sot po i mungon anëtarët e Kabinetit. Nuk është edhe mirë, nuk është serioze kjo punë.

Të kam vetë njëqind herë ku na me iu drejtu ke fukë Gllarevës, Gllareva kurrkund s'po rrinë. Po e bëhem pak më serioz.

Unë kam dashtë, sepse zoti Gllareva i ka heq dy rrugë në fshatin tim, dy segmente domethënë kanë pas me u asfaltu ato janë këtu rregullune krejt.

Edhe më vjen keq që qytetarët po mendojnë që shkak i jem, aty rrugë janë anulë prej

asfaltimit.

Ajo kam dashtë me pyet Gllarevën me i kallëzu qytetarëve, të paktën qytetarëve që nuk është faji im, është faji i Gllarevës edhe atyre që merren me këtë punë pse janë hjek prej asfaltimit ky segment.

Ka edhe rrugë tjera, po seriozisht nëse s'është prezent ai i kryetarit tana nuk mundet me i ditë ato rrugë, për sa është edhe i zgjidhur naj për rrugët për për këto tjera sene.

Hajde, kryetar!

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci:** 70 % po mungon kabineti.

Po, kabinetin e kam këtu, sot është 27, është dita e fundit që i bëjmë pranim-dorëzimet e projekteve të punës edhe i bëjmë pagesat.

Unë jam i lumtur, përkundër që nja një muaja e dytë na e keni shtyë sheshin, kena mbërri me harxhu një pjesë të buxhetit edhe na ka mbet një pjesë me harxhu si rezultat i vonesave, zoti Gllareva është në punë intensive për ta shpenzu buxhetin sa më shumë që na me mbetë në garë për grant performancës për vitin që e kemi lanë, sigurisht që s'kena me marrë grantin e performancës, ju kam shpjegu, vendin e parë e morëm gjithsesi, por granti i performancës i ka edhe katër shtylla, kur njëri nuk e kalon, nuk e merr grantin, siç është raporti i auditorit, shkak të keqklasifikimit, si na kanë quajhtë ata, të pasqyrave financiare, të pagave, të kontratave të shëndetësisë të arsimit e të tjera, na jena keqklasifiku.

Kësaj radhe jena shumë mirë, jam i lumtur, sepse komuna i fiton nja tre-katër milionë për këtë vit po vitin që e lamëna i kemi hapur nja tre-katër milionë edhe jua kam bo me dije që unë e kam paditë Ministrinë e Shëndetësisë edhe Ministrinë e Arsimit për shkak se si rezultat i gabimeve të tyre i kontratave kolektive që i kanë lidh pa zotimin e mjetevedhe në dëm të komunave, sigurisht që kom ja, kam thënë që kom ja shtu edhe pjesën e grantit që kishim me e fitu.

Nuk besoj që i ka hjek Endriti ose z.Gllareva ato dy segmente në katunin e juve, po sigurisht s'kanë mujt me u kry, sepse jo të gjitha punët kemi mujt me i kry.

Kena projekte prej 2012 Rruga "Kroni Mbretit" në Drenas, veç unë e di të zi të ullinit e kam mjek me mundu me përfundu dhe akoma nuk e kemi përfundu.

Kena projekte që i kena bast në fshatrat Koroticë, Vasilevë e tjera tjera, të cilat nuk i kanë kry operatorët fare për shkak të pandemisë, edhe përkundër që na me ligj na ka leju Qeveria me bo pagesa njëzet për qind, po as ato nuk i kanë dashtë edhe na kanë dëmtu.

Pra, qindra-mijëra euro na kanë humbë si rezultat edhe i pandemisë, po edhe i kompanive joserioze, siç i kemi edhe tash problemet e ndryshme.

Ju e dini që ne kemi pasur probleme edhe me rjetin e ujësjellësit, edhe me me bazenin e ujit të pijes në Kamenicë, i cili për mos me i humb edhe nja tre-katër vjet në gjykata, na kena hi me riparu dhe hala s'po është i zoti kompania me riparu, po lagen muret dhe na nuk mujt me dorëzuni diçka, i cili ka mbetë pa u kry, kështu që sikaton juve as nuk mund t'i akuzojnë njerëzit ty si ish-shkaktarë që nuk janë shtru ato rrugë.

Nëse ju e përçoni këtë mesazh atje, nuk bëni mirë se nuk është ashtu, por domethënë kanë mbetë si rezultat sigurisht i mosarritjes së përmbushjes së planit.

**Mehedin Salihu:** Unë kërkoj prej kryetarit që ndoshta aq i nxënë nuk është, Endriti në mbledhje të ardhshme me me qenë pesë-gjashtë minuta edhe unë me argumentu këtë që po them, dhe nuk e besoj najherë që ke pasë opozitë më konstruktive si tani, kurrë pengu nuk të

ka, të ka dalë ndihmë sa herë ke pas nevojë, hiç nuk e besoj që kena bo pengesë najherë edhe jena në gjendje për të mirën e vendit me ba çka do të qoftë me bashkëapunu.  
